



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2904 Prot.

Himarë, më 07.04. 2025

VENDIM

Nr. 17, datë 02.04.2025

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE NË
TERRITORIN E BASHKISË HIMARË”**

Bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*, ligjin Nr.44/2025 “Kodi i procedurave administrative”, në ligjin Nr.93/2015 “Për turizmin”, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, ligjin Nr. 10279/2010 “Për kundravajtjet administrative”, ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-në nr. 408/2015 (i përditësuar me anë të VKM nr.377/2024) “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e sjellë nga administrata e miratoi me 19 (nëntmbëdhjetë) vota pro, 1 (një) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores për shfrytëzimin e hapësirës publike në territorin e Bashkisë Himarë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të gjithë aktet që bien ndesh me këtë rregullore, shfuqizohen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.



KRYETARI

Dhimitër KAPAJ

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2904/1 prot.

Himarë, më 07.04.2025

RREGULLORE

PËR

SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE

NË

TERRITORIN E BASHKISË HIMARË

Miratuar me Vendim Nr. _17_, dt. 02._.04_. 2024 të Këshillit Bashkiak.

Spile, Himarë, tel. : 039322355, fax. 039322533 www.himara.gov.al e-mail: info@himara.gov.al

Tabela e Permbajtjes

PJESA E PARË	3
KREU I : DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	3
PJESA E DYTË	9
KREU I	9
ZËNIA E HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E AKTIVITETEVE RESTORATIVE DHE/OSE REKREATIVE	9
KREU II	16
DISTANCAT QË DUHET TË RESPEKTOHEN	16
KREU IV	23
EKSPOZIMI I MALLRAVE JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT	23
KREU V	25
ZHVILLIMI I PANAIREVE	25
KREU VI	27
ZËNIA E HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE PROMOVUESE, ARTISTIKE, KULTURORE, MANIFESTIMEVE POLITIKE E TË TJERA	27
KREU VII	29
ZËNIA E HAPËSIRËS REKLAMUESE (<i>CITY LIGHTS</i>) DHE (<i>TABELAT REKLAMUESE/ LED</i>)	29
KREU VIII	31
ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE AMBULATORE NË HAPËSIRAT PUBLIKE TREGJET	31
KREU IX	35
DISPOZITA TË FUNDIT	35
PJESA E PARË	

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e zënies/përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë e Himares.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve për një përdorim sa më uniform të hapësirës publike me qëllim krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit dhe sigurisë publike, nëpërmjet krijimit të një marrëdhënie transparente ndërmjet komunitetit dhe organeve autorizuese dhe inspektuese të Bashkisë Himare, me qëllim disponimin racional të burimeve të përbashkëta.

3. Rregullorja përcakton procedurat për dhënien e lejes, sipas kategorisë së aktivitetit që do të ushtrohet nga subjekti/et e interesuar dhe pajisjeve që do të lejohen të përdoren në një hapësirë publike të caktuar.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllime të aplikimit të kësaj rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Hapësirë publike”** është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar).
2. **“Shërbimet e lejuara”**, shërbimet që autoriteti vendor lejon të kryhen në hapësirë publike, sipas kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, dhe që janë të përputhshme me ndërtimet rreth hapësirës ku ato krijohen, sipas ligjit dhe dokumenteve të planifikimit.
3. **“Mobilimi urban”**, procesi i projektimit, ndërtimit dhe/ose vendosjes në hapësirë publike të objekteve apo ndërtimeve të lëvizshme ose jo, me qëllim përmirësimin e cilësisë funksionale dhe estetike të saj, rritjen e sigurisë publike dhe, sipas rastit, zbutjen e trafikut. Objektet e mobilimit urban përfshijnë vegjetacion, shtresat në sipërfaqen e hapësirave publike, stola, shatërvanë, instalime artistike, skulptura, tabela për emërtime të rrugëve apo reklamime, kabina telefonike, kosha për mbeturina, ndriçues, semaforë, trarë dhe objekte kufizimi të parkimit ose për ngadalësimin e automjeteve, kuti postare etj.
4. **“Aktivitete rekreative dhe restorative”**, përfshihen por pa u kufizuar aktivitete si, baret, restorantet, piceri, fast-food, hotelieri, si dhe çdo shërbim tjetër që ushtrohet në sektorin e shërbimeve sociale.
5. **“Strukturë e përkohshme mikse”**, është një strukturë e vogël e përkohshme dhe e çmontueshme, në të cilën shiten pije, cigare dhe sende të tjera të ngjashme kinkalerie, përfshirë revistat apo gazetatat, me sipërfaqe max 6 m².
6. **“Trotuar”**, është zona ndërmjet objekteve dhe karrexhatës që përdoret për aksesin e këmbësorëve. Matet nga fasada e objektit deri në fundin e bordurës së trotuarit.
7. **“Bordura”**, është element i parë që ndan karrexhatën me trotuarin.
8. **“Element Urban”**, është zona në të cilën bëjnë pjesë elemente si pemë në krah të trotuarit, gjelbërim apo shkurre, koshat e plehrave, reklamat, ndriçuesit rrugor, stolat etj.

9. **"Zonë Lëvizëse"**, është hapësira publike që lejon kalimin e këmbësorëve në mënyrë lineare, paralel me karrexhatën dhe pa ndërprerje e cila duhet të jetë e lirë gjithmonë.
10. **"Frontazhi"**, është hapësira publike përpara fasadës së objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomik. Pajisjet e përcaktuara më lart duhet të vendosen brenda zonës së frontazhit për të cilën jepet leja.
11. **"Njësi tregtimi"** është ambienti i mbyllur (dyqan) në të cilin subjekti kryhen aktivitetin e tij. Njësitë e tregtimit mund të jenë të shkëputura nga ndërtesa ose mund të përfshihet në të.
12. **"Me pajisje"**, kuptohen struktura metalike, plastike ose druri të cilat shërbejnë për ekspozimin e mallit përpara njësisë së tregtimit.
13. **"Panaire të përgjithshëm"**, nënkupton panairët që janë të pa limituar nga karakteristikat e tyre merceologjike. Këto lloj panairesh mund të organizohen në sektorë të ndryshëm. Në këto panaire ndalohet shitja e armëve, lëndëve eksplozive, objekteve/sendeve me vlerë.
14. **"Panaire të veçantë merceologjike"**, janë panaire në të cilat tregtohen dhe ekspozohen mallra vetëm të një sektori të veçantë merceologjik.
15. **"Aktiviteti tregtisë ambulatorë në hapësirat publike"**, kuptohet organizimi i saj në formën e tregjeve fiks ose të lëvizshëm.
16. **"Treg i lëvizshëm"**, kuptohet ajo formë organizimi e tregtisë ambulante në hapësirat publike që kryhet nëpërmjet grupimit të tregtarëve ambulantë në vende të caktuara, një ditë dhe një orë të caktuar, të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre me anë të pajisjeve të çmontueshme (banakë, tezga).
17. **"Aktivitet njësi shitjeje ambulatorë në hapësirat publike"**, kuptohet çdo njësi shitjeje ambulantë e lëvizshme jashtë tregjeve.
18. **"Ambulant"** është personi fizik, i cili tregon mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend biznesi fiks, që ushtron aktivitetin në njësi të vetme tregtimi të lëvizshme dhe lejohet të tregtojë në ambiente publike pasi është pajisur me leje nga bashkia nën juridiksionin territorial dhe administrativ.

Neni 3

Aktivitetet e lejuara në hapësirat publike

Kategoritë e aktiviteteve që lejohen të ushtrohen/zhvillohen në hapësirat publike të Bashkisë janë:

- a) Ofrimi i shërbimeve restorative, rekreative si dhe shërbime në funksion të përmirësimit të veprimtarisë urbane *(por pa u kufizuar, në bare, restorante, fast-food, piceri, hoteleri e të ngjashme)*;
- b) Zhvillim i aktiveve ambulatorë në hapësirat publike;
- c) Ekspozimi i mallrave jashtë njësisë së tregtimit;
- d) Zhvillimi i panaireve;

- e) Zhvillim i aktiviteteve argëtuese, kulturore, sportive dhe manifestimet politike;
- f) Hapësirat reklamuese (*City Lights*) dhe (*Tabelat Reklamuese Led*);
- g) Strukturat e përkohshme mikse (ATM)
- h) Per karkikimin e mjeteve elektrike

Neni 4 Procedura e pajisjes me lejen përkatëse

1. Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë aktivitet në hapësirat publike duhet të pajiset me leje nga strukturat përkatëse të Bashkisë Himare.
2. Subjektet që evidentohen duke përdorur hapësirë publike dhe nuk janë të pajisur me lejen përkatëse, procedura e pajisjes me leje nga struktura përkatëse, do të vijojë bazuar në aktkontrollin e mbajtur nga inspektorët e Drejtorise së Zhvillimit Ekonomik .
3. Nëse subjekti kërkon leje për një hapësirë publike në një zonë me vlera monumentale, kjo leje do të lëshohet në bashkëpunim/bashkërendim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Afatet për shqyrtimin e kërkesave ndryshojnë në varësi të kategorisë së aktivitetit dhe lejes së kërkuar, por në çdo rast nuk tejkalohet afati 30 ditor nga momenti i marrjes së aplikimit.
5. Nëse gjatë shqyrtimit të aplikimit subjekti i interesuar ndryshon qëndrim, subjekti duhet t'ia komunikojë atë strukturës përkatëse në Bashkinë Himare brenda afatit të shqyrtimit të kërkesës.
6. Subjekti është i detyruar që lejen e lëshuar nga Bashkia Himare ta ketë të vendosur në një vend të dukshëm në rastet kur kemi të bëjmë me zënie të hapësirës publike të qëndrueshme.
7. Në të kundërt, të ketë lejen kurdoherë me vete nëse zënia e hapësirës publike kryhet në mënyrë jo të qëndrueshme.
8. Leja për ushtrimin e aktivitetit lëshohet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë shfrytëzimit të hapësirës publike dhe pronës së paluajtshme të shtetit.

Neni 5 Afati i lejes për përdorimin e hapësirës publike

1. Ushtrimi i aktivitetit në hapësirat publike është i përkohshëm. Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit përcaktohet në varësi të kategorisë së aktivitetit që subjekti kërkon të ushtrojë. Për disa kategori të caktuara ushtrimi i aktivitetit në hapësirën publike mund të jetë i kufizuar vetëm në ditë apo në orë të caktuara.
2. Afati maksimal për kohëzgjatjen e lejes për ushtrim aktiviteti nuk mund të jetë më shumë se 1 (nje) vit kalendarik me të drejtë rinovimi, por gjithmonë me kërkesë të subjektit.

Neni 6 Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

- 1.** Lejohet vetëm përdorimi i pajisjeve të përcaktuara në lejen për zënien e hapësirës publike. Përcaktimi i formave, materialeve, përmasave dhe ngjyrat e tyre do të përcaktohen me vendim të Kryetarit të Bashkisë
- 2.** Pajisjet duhet të jenë lehtësisht të çmontueshme dhe nuk duhet të kenë pamje estetike të konsumuar dhe të çrregullt.
- 3.** Në zona me rëndësi të veçantë social-kulturore apo ekonomiko-administrative, në të cilat synohet të kultivohet dhe ruhet një estetikë urbane uniforme, përdorimi i formave, materialeve dhe ngjyrave specifike për pajisjet nga subjektet e interesuar, nëse nuk janë të përcaktuara me vendim të veçantë, do të zbatohet procedura sipas pikës 1 të këtij neni.
- 4.** Nëse me akte të Kryetarit të Bashkisë ndryshojnë format, përmasat apo ngjyrat e pajisjeve në një zonë të caktuar, atëherë pajisjet duhet të ndryshohen sipas udhëzimeve pa pasur nevojë për një leje të re. Drejtoria Zhvillimit Ekonomik ka për detyrë t'ia komunikojë këtë subjekteve, ndërsa subjektet kanë për detyrë të bëjnë ndryshimet me shpenzimet e tyre.

Neni 7

Ndalimet

Ndalohet zënia e hapësirës publike në rastet kur:

- 1.** pengon qarkullimin normal të këmbësorëve dhe automjeteve dhe cenon sigurinë publike, në buzë të trotuarit që korrespondon me vazhdimin e vijave të bardha për lëvizjen e këmbësorëve;
- 2.** në ishujt e trafikut. Përrashtime bëjnë ato raste në të cilën kjo nuk përbën asnjë shqetësim për lëvizjen e këmbësorëve dhe atë të automjeteve;
- 3.** në vendndalimet dhe vendqëndrimet e përcaktuara për mjetet e transportit;
- 4.** në rastet kur bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore;
- 5.** dëmton/cënon dekorin e qytetit;
- 6.** nuk përmbush normat higjeno-sanitare;
- 7.** bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
- 8.** cënon aksesin për hyrje daljet në banesat kolektive, duke respektuar distancë minimumi 1 m nga kufiri i hyrjes në banesë.
- 9.** bie në kundërshtim me distancën e sigurisë nga stacionet e karburantit, që gjithsesi nuk mund të jetë më pak se 5 m distancë nga to apo të bllokojë hyrje-daljet në stacionin e karburantit.

10. në vendet që ka monumente duhet lënë një hapësirë e nevojshme, e cila të mos e pengojë shikimin e monumentit;
11. Në zonat me vlera historike me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm në rastet kur garantohej një lëvizje e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
12. Në kryqëzimet në të cilët nuk ka semaforë zënia e hapësirës publike mund të bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit, pra të mos përbëjë asnjë vështirësi në shikim.

Neni 8 Mirëmbajtja dhe dëmtimet

Subjekti, i cili është pajisur me leje për zënien e hapësirës publike, duhet:

1. të garantojë një përdorim të sigurtë të hapësirës publike për kalimtarët, në përputhje me dekorin e qytetit dhe në gjendje perfekte higjeno-sanitare.
2. të mirëmbajë pajisjet, të cilat duhet të jenë gjithnjë në rregull dhe të pastra dhe të mos të mbaj apo të vendos asnjë send tjetër, përveç asaj të miratuar në lejen për ushtrim aktiviteti (*kutia ambalazhi, etj*).
3. të mbajë pajisjet në eficientë të plotë, në rast të kundërt ndaj tij do të merren masa deri në anulimin e lejes.
4. Çdo dëm që i shkaktohet hapësirës publike apo qytetarëve nga aktiviteti që zhvillohet, do t'i faturohet subjektit i cili është i pajisur me leje.

Dëmi ekonomik, si dëmtim në trotuar, pemë apo hapësirën e gjelbër, vlerësohet nga strukturat përkatëse të Bashkisë Himare në përputhje me aktet ligjore të miratuara për këtë qëllim.

Neni 9 Kthimi i hapësirës publike

1. Hapësira publike duhet të lihet e lirë nga çdo pajisje në rastet kur strukturat përkatëse të Bashkisë Himare duhet të kryejnë punime në interes të publikut, ose punime mirëmbajtje.
2. Struktura e Bashkisë Himare, të paktën 15 ditë para fillimit të punimeve, duhet t'i komunikojë subjektit me shkrim datën në të cilën hapësira duhet lënë e lirë.
3. Kur hapësira publike duhet lënë e lirë në mënyrë urgjente, komunikimi nga ana e strukturave përkatëse mund të bëhet në mënyrë verbale duke konfirmuar në vijim e pa vonesë në formë të shkruar. Kur nuk është i mundur komunikimi verbal (*aktiviteti është mbyllur*), në këtë rast punonjësit e Policisë Bashkiake në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Bashkisë Himare kryejnë lirim të territorit dhe koston e punimeve ia faturojnë subjektit.
4. Hapësira publike duhet të kthehet në gjendjen e saj të mëparshme në rastet kur:
 - a) subjekti nuk është i lejuar të ushtrojë aktivitetin;
 - b) kalon data e përfundimit të lejes;
 - c) anulohet leja/autorizimi.

5. Nëse lirimi i saj nuk bëhet nga vetë subjekti, Policia Bashkiake në bashkëpunim me inspektorët e Drejtorise se Zhvillimit Ekonomik marrin masa për lirimin e hapësirës publike dhe të gjitha shpenzimet për lirimin e saj i faturohen subjektit përgjegjës.

Neni 10 Masat ndëshkuese

1. Në të gjitha rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje nga subjekti i interesuar të kushteve të përcaktuara në lejen për zënien e hapësirës publike, ndaj subjektit të interesuar do të merren masat ndëshkuese, si më poshtë: **a)** Paralajmërim me shkrim/akt konstatimi;

b) Gjorbë;

c) Pezullim;

d) Shfuqizimi i lejes.

e) Çmontim të strukturës

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, konsiderohen shkelje:

a) Zënia e hapësirave publike pa u pajisur më parë me lejen përkatëse;

b) Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në lejen që i është dhënë;

c) Instalimi i pajisjeve për të cilat nuk ka marrë lejen përkatëse;

d) Kur mosmirëmbajtja e pajisjeve dëmton/cenon dekorin e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;

e) Subjekti nuk mban pastër hapësirën e cila i është lënë në dispozicion;

f) Subjekti nuk paguan tarifën për zënien e hapësirës publike brenda afateve të përcaktuara në leje;

g) Subjekti prish qetësinë publike apo ka sjellje të padenjë;

h) Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo anulimit;

i) Kur zënia e kryer nuk është në përputhje me kriteret që janë përcaktuar në lejen e dhënë si edhe;

j) Në ato raste kur shkeljet mund të jenë të ndryshme dhe të sanksionuara në akte të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi.

3. Për çdo shkelje të konstatuar të lejes apo dëmtim të hapësirës publike masat do të jenë si më poshtë:

a- Për shkeljet sipas pikave a,d,e,g, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, për konstatimin e parë do të aplikohet masa ndëshkuese e parashikuar në pikën 1 gërma a. të këtij neni. Nëse subjekti brenda 5 ditëve nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në akt-konstatimin e mbajtur prej inspektorëve të Drejtorise se Zhvillimit Ekonomik , ndaj tij do të merren masa e parashikuar në pikën 1 gërma b të këtij neni.

b-Për të gjitha shkeljet e tjera të pikës 2 të këtij neni, do të aplikohet masa ndëshkuese sipas pikës 1 gërma b të këtij neni.

4. Për shkeljet e përsëritura dhe të gjobitura për më tepër se tre herë organi inspektues i propozon strukturës përkatëse që ka lëshuar lejen, marrjen e masën së pezullimit deri në korrigjimin e mangësive të konstatuara. Pezullimi jepet për një periudhë maksimale prej 10 ditë.

5. Nëse subjekti nuk ndërmerr masat e nevojshme për të korrigjuar mangësitë e konstatuara brenda periudhës së pezullimit, organi inspektues ia komunikon statusin Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, e cila në vijim fillon nisjen e procedurës për anulimin e lejes së lëshuar për subjektin e interesuar. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban merr vendim për anulimin e lejes brenda 15 ditëve nga marrja e sinjalizimit për moskorrigjimin e mangësive.

6. Për secilën nga shkeljet e konstatuara masat ndëshkuese janë të integruara/kumulative, sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes. Masat për çdo shkelje do merren sipas procedurave të ndjekura nga organet inspektuese konform kësaj rregullore dhe ligjeve në fuqi.

7. Aktet e kontrollit, të mbajtura gjatë inspektimit, ankimohen nga subjekti i interesuar në përputhje me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" të cilat më pas i dërgohen për vlerësim Kryetarit të Bashkisë.

Neni 11

Detyrimet financiare

1. Dhënia e çdo leje për zënie e hapësirës publike kushtëzohet nga pagesa e tarifës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë së Himarës" (i ndryshuar), e cila varion në bazë të zonës në të cilën subjekti zhvillon aktivitetin e tij dhe sipërfaqen e hapësirës publike të zënë në m².

2. Pagesa bëhet pranë bankave të nivelit të dytë, insitucioneve financiare të licensuara nga Banka e Shqipërisë si dhe pranë Postës Shqiptare.

Neni 12 Të tjera

1. Lejohet që subjekti të vendosë pajisje reklamuese për produktet ose shërbimet që ofron vetëm pasi ai të jetë pajisur me lejen përkatëse nga organi autorizues.

2. Para se aplikanti të dorëzojë dokumentet për marrjen e lejes për të zënë hapësirën publike duhet të kontrollojë informacionet e ofruara nga Drejtoria e Urbanistikës për zonat në të cilat lejohet aplikimi dhe dokumentet që ai duhet të paraqesë.

3. Informacionet e nevojshme që do t'i shërbejnë subjekteve mbi kategoritë e aktiviteteve që zhvillohen në hapësirat publike ato mund t'i gjejnë:

a) Pranë Drejtorisë së Lejeve dhe Administrimit të pronave publike;

- b)** Në materialet promovuese;
- c)** Në buletine;
- d)** Në faqen e internetit të Bashkisë Himare.

PJESA E DYTË

KREU I ZËNIA E HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E AKTIVITETEVE RESTORATIVE DHE/OSE REKREATIVE

Neni 13 Leja për hapësirën publike

Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të zhvillimit të aktiviteteve restorative dhe/ose rekreative duhet të pajiset me lejen përkatëse, e cila lëshohet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

Neni 14 Afati, dokumentacioni dhe procedura aplikimit

1. Afati i lejes për këto kategori aktiviteteve është 1 vjeçar me të drejtë rinovimi me kërkesë të subjektit. Me kërkesë të vetë subjektit kjo leje mund të lëshohet edhe për periudha sezonale, por në çdo rast jo më pak se një afat për 3 muaj.
2. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën pranë Bashkisë Himare.
3. Subjektet aplikues duhet t'i përmbahen rregullave për plotësimin e dokumentacionit teknik/hartografik, që kanë të bëjnë me genplanin ose planimetritë dhe fotot e njësive ku ato zhvillojnë aktivitetin e tyre, si:
 - a) Kërkesë me shkrim
 - b) Plan vendosje për hapësirën publike që kërkohet të shfrytëzojë.
 - c) Foto të qarta, ku të pasqyrohen veçmas pamja ballore, pamjet anësore, foto e hapësirës që kërkohet të përdoret dhe për njësitë e mbyllura edhe një pamje e brendshme.
 - d) Dokumentin e pronësisë ose kontratën e qerasë.
 - e) Kopje të kartës së identitetit
 - f) Kopje të ekstraktit historik
 - g) Si dhe çdo dokument tjetër që vlerësohet i nevojshëm
4. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban është 15 ditë nga data e marrjes së aplikimit.
5. Lejet për ushtrim aktiviteti jepet vetëm pasi janë marrë miratimet dhe autorizimet përkatëse për sa më sipër, si dhe në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Neni 15 Format e zënies së hapësirave publike

1. Aktivitetet restorative dhe/ose rekreative mund të zhvillohen në një nga format e mëposhtme:

a) Në hapësira publike të parrethuara (*njësi e hapur*);

b) Në hapësira publike të rrethuara (*njësi e kufizuar*).

2. Në kuptim të këtij kreu të kësaj rregullore, me njësi të hapur kuptohet një hapësirë e pambyllur (*e parrethuar*), përpara lokalit dhe ku janë vendosur tavolina dhe karrige me qëllim shërbimin e pijeve, ushqimit apo ku janë vendosur lodra për fëmijët. Këto hapësira mund të kompletohen dhe me pajisje të tjera si, tenda me strehë, tenda diellore, tenda me bimë kacavjerrëse dhe çadra dielli.

3. Hapësira publike e parrethuar asnjëherë nuk mund të mbyllet me mjete të tjera të cilat nuk janë përcaktuar në lejen e lëshuar për zënien e hapësirës publike.

4. Me njësi të kufizuar, në kuptim të këtij kreu kuptohet një hapësirë ku janë vendosur tavolina dhe karrige me qëllim shërbimin e pijeve, ushqimin apo ku janë vendosur lodra për fëmijët e cila është e rrethuar me mjete dekorative, erë pritëse e të tjera të ngjashme me to, me strukturë me konstruksion të lehtë të çmontueshëm, e mbuluar me tendë me material plastik, beze etj.

Neni 16 Tipet e pajisjeve të lejuara

1. Në hapësira publike të parrethuara, njësi e hapur, lejohen të vendosen pajisjet si më poshtë:

a) Tavolina;

b) Tenda me strehë;

c) Tenda diellore;

d) Tenda me bimë kacavjerrëse;

e) Çadra dielli;

f) Lojëra për fëmijë.

2. Në hapësira publike të rrethuara, njësi e kufizuar, lejohen të vendosen pajisjet si më poshtë: **a)**

Tavolina;

b) Tenda me strehë;

c) Tenda diellore;

d) Tenda me bimë kacavjerrëse;

e) Çadra dielli;

ë) Strukturë e përkohshme me materiale të çmontueshme

- f)** Strukturë e lehtë hijëzuese me material druri, polikarbonat, metalike etj
- g)** Saksi dhe elementë kufizues;
- h)** Pedana dhe tapete;
- i)** Erëpritëse;
- j)** Lojëra për fëmijë

3. Kushtet dhe kriteret që zbatojnë subjektet që pajisen me lejen për zënien e hapësirës publike në lidhje me vendosjen e tipeve të ndryshme të pajisjeve në hapësirat publike janë të përcaktuara në nenet në vijim të këtij kreu.

Neni 17 Zënie e hapësirave publike me tavolina

1. Zënia e hapësirës publike me tavolina dhe karrige, sipas kriterëve të lejes së lëshuar, bëhet si më poshtë:

- a)** Zënia kryhet ngjitur me fasadën e godinës;
- b)** Zënia kryhet në trotuaret portik;
- c)** Zënia kryhet në sheshet dhe hapësirat publike

2. Tavolinat dhe karriget në asnjë rast nuk duhet të dalin jashtë hapësirës së përcaktuar në lejen e lëshuar për këtë qëllim.

3. Gjatë orarit të mbylljes, tavolinat dhe karriget duhet të largohen nga kjo hapësirë dhe të vendosen në mënyrë të rregullt në një zonë të caktuar, nëse kjo ndihmon itineraret e lëvizjes në zona të caktuara. Këto zona përcaktohen sipas urdhrave dhe vendimeve të Kryetarit të Bashkisë.

4. Forma, materialet dhe ngjyrat e tavolinave janë në diskrecion të plotë të subjektit që pajiset me leje, përveç rasteve kur me vendime të Këshillit Bashkiak/Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme e specifike për zonën.

Neni 18 Tendat me strehë

1. Tenda me strehë është struktura që përbëhet nga materiale sintetike apo pëlhura tekstili, të vendosura në pjesën e jashtme të njësisë, pa pikëmbështetje në truall, që shërbejnë për mbrojtjen nga dielli, reshtje e shiut apo shkaqe të tjera si pasojë e motit të keq.

2. Tenda vendoset kudo që të jetë e mundur, duke u përshtatur dhe me fasadën e ndërtesës.

3. Tendat duhet të vendosen për çdo vitrinë në mënyrë të veçantë. Në rastin kur fasadat paraqesin veshje të veçanta në tullë, gurë ose materiale të tjera me vlerë, ndalohen instalimet që shkaktojnë tjetërsim të fasadës. Po ashtu janë të ndaluara tjetërsimet e elementëve të dekorit.

4. Është i lejueshëm reklamimi pasi të jetë marrë autorizimi për këtë qëllim nga organi kompetent. Reklama duhet të vendoset në ekstremin e poshtëm të tendës me një madhësi të rregullt dhe të harmonizuar.

5. Gjatë periudhës së mbylljes së aktivitetit, tendat me strehë të cilat janë të dala më shumë se 1 m nga fasada nuk duhet të jenë të hapura.
6. Pamja, materialet dhe ngjyrat e tendës janë në diskrecion të plotë të subjektit që pajiset me leje, përveç rasteve kur me vendime të Këshillit Bashkiak/Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme e specifike për zonën.

Neni 19

Tendat diellore

1. Tendat diellore janë struktura me mbulesë sintetike ose pëlhure projektuar me pikëmbështetje mbi truall duke mos cënuar elementët e veçantë dekorues të shtrimit.
2. Tendat diellore nuk duhet të bllokojnë fushën e shikimit. Ndalohen të gjitha mbylljet ballore dhe anësore. Strukturat duhet të jenë rezistente ndaj erërave. Për këtë duhet të jenë të fiksuara mirë në truall në mënyrë që të mos përbëjnë asnjë rrezik për kalimtarët dhe të mos cenojnë sigurinë dhe jetën e njerëzve.
3. Me përjashtim të rasteve kur me vendime të Këshillit Bashkiak/Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme e specifike për zonën, strukturat duhet të jenë ndërtuar prej:
 - a) Mbështetëse druri, hekuri dhe/ose alumin i ngjyrosur;
 - b) Pëlhurë beze, pëlhurë akrilike, pvc.
4. Në qendrat historike, për sa i përket ngjyrave, do të mbahen parasysh karakteristikat e veçanta të objektit në fjalë.
5. Kjo strukturë lejohet vetëm për atë kategori subjektsh të cilat objektin e aktivitetit për të cilin krijohen e ushtrojnë brenda sipërfaqes së strukturës për të cilën aplikojnë.

Neni 20 Tenda me bimë kacavjerrëse

1. Tenda me bimë kacavjerrëse është struktura metalike ose druri me pikëmbështetje në truall e mbuluar me bimë kacavjerrëse, duke mos cënuar elementët e veçantë dekorues të shtrimit
2. Lartësia minimale e tendës me bimë kacavjerrëse nga trualli duhet të jetë 2.2 metra.
3. Kjo kategori tendash është e preferueshme të vendoset në parqe dhe lulishte, ku ajo mund të përshtatet shumë mirë nga ana dekorative.
4. Është e ndaluar që mbi ose nën bimët kacavjerrëse të vendoset një mbulesë tjetër sintetike apo pëlhure. Është i ndaluar ndërtimi i kësaj kategorie tendash me bimë helmuese.
5. Bimët duhet të jenë objekt i kujdesit të vazhdueshëm. Sipërfaqja e truallit mbi të cilin është vendosur tenda duhet të mbahet pastër nga gjethet.

Neni 21 Çadrat e diellit

1. Çadra dielli janë strukturat mbajtëse me mbulesë beze të instaluar vetëm në një pikëmbështetje në truall, duke mos cënuar elementët e veçantë dekorues të shtrimit
2. Projektimi në truall i çadrave të diellit nuk duhet t'i kalojë limitet e sipërfaqes së dhënë në leje.
3. Lejohen shkrime publicitare, parashikuar në lejen e dhënë për reklamë, në pjesën e jashtme të çadrave. Këto reklama duhet të kenë një karakter të pranueshëm për zonën dhe ambientin ku do të vendosen këto çadra.
4. Çadrat diellore duhet të vendosen në bazamente të posaçme. Lartësia e telave të çadrës duhet të ketë një lartësi minimale prej 2.2 metra nga trualli.
5. Në rastet kur moti i keq shoqërohet me erëra të forta apo stuhi, çadrat diellore duhet të jenë të mbyllura, duke mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e njerëzve. Gjatë natës, çadrat e diellit duhet të mbyllen ose të largohen nga hapësira publike e zënë.
6. Materialet dhe ngjyrat e përdorura për çadrat e diellit janë në diskrecion të plotë të subjektit që pajiset me leje, përveç rasteve kur me kur me vendime të Këshillit Bashkiak/ Kryetarit të Bashkisë përcaktohen rregulla të ndryshme e specifike për zonën.

Neni 22 Strukturë e përkohshme me materiale të çmontueshme

Struktura te lehta të përkohshme mbi hapësirën publike duhet të respektojnë sipërfaqet e miratuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, sipas planvendosjes së SPL- së.

- Struktura te lehta të përkohshme në hapësira publike është një strukturë e çmontueshme me pikë mbështetje në tokë dhe mund të ketë forma të ndryshme, e cila mund të lidhet me objektin ose mund të qendrojë e vetme.
- Dizajni i strukturës duhet të reflektojë llojin dhe periudhën e objektit që ka pranë.
- Format i strukturave te jete sipas aneksit 1 bashkelidhur kesaj rregullore
- Proporcionet duhen gjykuar rast pas rasti në varësi të hapësirës së lejuar për përdorim.
- Materialet që përdoren, janë kryesisht: dru, metal apo dhe të ndërthuren 2 materiale njëkohësisht.
- Mbulesa e strukturës së lehtë të përkohshme mund të jetë me cope, polikarbonat, metalike etj...
- Mund të jenë me bimë kacavjerrëse.
- Mbulimi i strukturës së lehtë të përkohshme me materiale të çmontueshme, nuk duhet të ketë shumë kulme.
- Gjerësia maksimale e strukturës së përkohshme me materiale të çmontueshme duhet të jetë deri në kufijtë e vetratës/fasadës së objektit për aktivitet privat, nga do të shfrytëzohet hapësira publike.

- Strukturë e lehtë e përkohshme mund të përmbajë erëpritës, pedanë druri ose tapet.
- Ndalohet rrethimi vertikal i hapësirave publike me struktura të paçmontueshme.
- Lartësia e strukturës së lehtë të përkohshme në hapësirat publike, nuk duhet të tejkalojë kuotën e soletës së katit përdhe në pikën kulmore të saj.

Neni 23 Strukturë e lehtë hijëzuese me material druri, polikarbonat, metalike etj

Struktura e lehtë hijëzuese me material druri, polikarbonat, metalike etj... mbi hapësira publike duhet të respektojnë sipërfaqet e miratuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, sipas planvendosjes së SPL- së.

- Struktura e lehtë hijëzuese në hapësira publike është një strukturë e çmontueshme pa pikë mbështetje në tokë dhe mund të ketë forma të ndryshme, e cila lidhet me objektin.
- Dizajni i strukture duhet të reflektojë llojin dhe periudhën e objektit që ka pranë.
- Materialet që përdoren, janë kryesisht: material druri, polikarbonat, metalike apo dhe të ndërthuren 2 materiale njëkohësisht.
- Mbulesa e strukturës së lehtë të hijëzuese mund të jetë me cope, polikarbonat, metalike etj....
- Mund të jenë me bimë kacavjerrëse.
- Mbulimi i strukturës së lehtë hijëzuese me materiale të çmontueshme, nuk duhet të ketë shumë kulme.
- Gjerësia maksimale e strukturës së lehtë hijëzuese me materiale të çmontueshme duhet të jetë deri në kufijtë e vetratës/fasadës së objektit për aktivitet privat, nga do të shfrytëzohet hapësira publike.
- Vendosja e strukturës së lehtë hijëzuese në hapësirat publike, nuk duhet të tejkalojë kuotën e soletës së katit përdhe në pikën kulmore të saj.

Neni 24 Saksitë/vazot dhe elementet kufizuese

1. Saksi/vazo do të konsiderohen elementët që shërbejnë për të kufizuar dhe dalluar hapësirat publike për të cilat subjekti është pajisur me leje përkatëse për të shfrytëzuar këtë hapësirë.
2. Kufizimi i sipërfaqes së zënë duhet gjithnjë të ndërtohet si një rresht elementësh. Nëse aplikanti përfiton dy hapësira/sipërfaqe të veçuara, këto duhet të kenë të njëjtët elementë kufizimi.
3. Pajisjet e përshtatshme me të cilat mund të kryhet kufizimi janë, saksitë/vazot ose rrethime të tilla si litarë, parmakë, pëlhura erëpritëse e të tjera të ngjashme me këto.
4. Vendosja e vazove apo saksive me qëllim zbukurimi dhe jo për qëllime kufizimi të një sipërfaqeje të caktuar, mund të lejohet vetëm rrëzë murit të ndërtesës, me kusht që të mbeten

të lira zonat lëvizëse për kalimin dhe qarkullimin normal të këmbësorëve. Kufizimi nuk duhet të kalojë sipërfaqen e caktuar në leje.

5. Për të lejuar një hapësirë shikimi më të madhe, saksitë duhet të vendosen në mënyrë të tillë që ndërmjet tyre të ketë një hapësirë minimale sa gjysma e gjatësisë së një saksie.
6. Rrethimet nuk duhet të jenë në kontrast me karakteristikat arkitektonike të zonës. Në sipërfaqet këmbësore të qendrave historike të cilat mund të jenë të ngushta e të reduktuara, elementë të tillë kufizues mund të futen në një numër shumë të vogël.
7. Kur saksitë janë të vendosura:
 - a) si kufizues të sipërfaqes rrëzë murit të ndërtesës, lartësia e tyre nuk duhet të kalojë 1,2 m përfshirë këtu dhe bimën;
 - b) rrëzë murit me qëllim zbukurimi, lartësia e tyre është e lirë, gjerësia e vazos nuk duhet të kalojë 0,8 m dhe bimët nuk duhet të dalin jashtë vazos;
 - c) të gjitha tipet e tjera të rrethimit duhet të kenë një lartësi maksimale prej 1 m.
8. Saksitë nuk duhet të kenë mbishkrime reklamuese *(me përjashtim të rasteve të veçanta me autorizim përkatës nga Drejtoria e Urbanistikës)*.
9. Erëpritëset mund të mbajnë emrin ose logon e aktivitetit me kusht që përmasat të mos kalojnë 20% të sipërfaqes së tyre. Tipet e tjera të rrethimit nuk duhet të mbajnë asnjë lloj reklame.
10. Vazot/saksitë duhet të mirëmbahen. Bimët duhet të jenë rezistente ndaj agentëve të jashtëm dhe të mbajtura në gjendje të mirë. Nuk duhet të jenë të prishura apo të infektuara nga parazitët. Saksitë e lëna pas dore, të thyera, me bimë të kalbura duhet të hiqen nga subjektet që i kanë vendosur në të kundërt do të merren masa ndëshkimore.
11. Në rastet kur nga strukturat konstatuese të Bashkisë Himare vërehet se këto bimë janë të kalbura apo të pa mirëmbajtura, njoftojnë subjektin dhe Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për marrjen e masave për pezullimin apo heqjen e lejes së dhënë për zënies e hapësirës publike.
12. Mbështetjet në truall nuk duhet të pengojnë ose rrezikojnë qarkullimin e këmbësorëve dhe duhet të garantojnë një qëndrueshmëri të mirë të rrethimit. Në rast se rrethimi kryhet me xhama, ato duhet të jenë të pathyeshëm.

Neni 25 Pedanat, shtrojet dhe tapetet

1. Pedanat, shtrojet dhe tapetet janë elementë që vendosen direkt në sipërfaqen e shënuar. Ato janë të sheshta ose të ngritura në rastin e pedanave dhe kanë si funksion zbukurimin e ambientit në të cilin do të vendosen objektet e përcaktuara në leje.
2. Ndalohet:
 - a) vendosja e pedanave, shtrojeve dhe tapeteve në trotuare publik, që mbartin vlera artistike dhe ambientale;

b) mbulimi i kapakëve të pusetave, rrjetave të ajrimit dhe të tjera të ngjashme me to, prerja dhe ngjeshja e rrënjëve që dalin mbi sipërfaqe, apo cdo dëmtim dhe prishje trotuari.

3. Pedanat dhe elementët e mundshëm të vendosur për mbrojtje dhe kufizim nuk duhet të kalojnë përmasat e sipërfaqes së dhënë në leje.

4. Pedanat duhet të jenë me strukturë lehtësisht të çmontueshme dhe duhet të kenë një lartësi maksimale 15 cm nga trualli dhe duhet të përputhen me kriteret e përcaktuara në leje.

5. Tapetet nëse janë të veçuara, duhet të jenë të mbajtura në anët nga vazot apo saksitë në mënyrë që të mos pengojnë qarkullimin.

Neni 26 Erëpritëse

1. Erëpritëse janë struktura komplekse, lehtësisht të çmontueshme dhe sezonale, me sipërfaqe të forta dhe transparente që shërbejnë për t'u mbrojtur nga era, të tilla si xham, polikarbonat etj. **2.** Erëpritësit duhet të kenë një lartësi maksimale prej 1,5 m

2. Struktura duhet të jetë e fiksuar në truall për çështje sigurie, por pa prishur shtresat e hapësirës publike (*pllakat, barin etj.*), lehtësisht e çmontueshme dhe struktura duhet të jetë brenda hapësirës së lejes së dhënë si dhe ajo nuk duhet të ndërhyjë në kurorën e pemëve.

3. Ndalohet përdorimi i çdo mjeti reklamues me përjashtim të një vetrofanie (*fletë e dizenuar me ngjyra, transparente, që vendoset mbi xham*) për secilën anë, që tregon emrin ose logon e aktivitetit, me përmasa jo më tepër se 20 % të sipërfaqes totale të së njëjtës anë.

4. Në rastet kur erëpritëset janë prej materiali xhami, ato duhet të kenë një shtresë të brendshme e cila në rast thyerje të xhamit pengon rënien e copave të thyera.

Neni 27 Lojërat për fëmijë

1. Lojëra për fëmijë do të konsiderohen strukturat komplekse, lehtësisht të çmontueshme, me sipërfaqe të fort dhe lartësi maksimale 2.2 m nga trualli, që shërbejnë për të luajtur fëmijët e vegjël deri në moshën 12 vjeç.

2. Struktura duhet të jetë e fiksuar në truall për çështje sigurie, por pa prishur shtresat e hapësirës publike përreth dhe lehtësisht e çmontueshme. Struktura duhet të jetë brenda hapësirës së lejuar dhe nuk duhet të ndërhyjë në kurorën e pemëve. Hapësirat dhe sipërfaqja që mund të përdoret, përcaktohet duke ju referuar distancave të lejuara në nenin 26 e vijuese të Kreut II i kësaj rregullore.

3. Lojërat për fëmijë të përdorura në hapësirën publike duhet të kenë specifikime teknike dhe çertifikatë sigurie me qëllim që të jenë të sigurta për fëmijët që do t'i përdorin.

4. Kur ato janë të vendosura në një sipërfaqe të fortë, të përdoret një shtresë në formë tapeti me sipërfaqe të butë.

5. Tapeti i butë mbrojtës duhet të sigurojë parametrat termike, parametrat e zbutjes së goditjeve, të jetë material higjenik etj, ku të jenë të përcaktuara në specifikimet teknike të materialit të përdorur.

KREU II DISTANCAT QË DUHET TË RESPEKTOHEN

Neni 28 Distanca

1. Në këtë kre përcaktohen kriteret për mënyrën e vendosjes së pajisjeve në hapësirën publike dhe distancat që duhet të respektohen me qëllim ruajtjen e zonave lëvizëse të këmbësorëve dhe unifikimin e përdorimit të tyre. Distancat e paraqitura në vijim aplikohen në të gjitha format e zënies së hapësirës publike dhe pajisjet e lejuara me qëllim zhvillimin e aktiviteteve restorative dhe/ose rekreative.

2. Distanca e Frontazhit përcaktohet në raport me dimensionet e hapësirës publike duke garantuar gjithmonë:

- a)** Zonën Lëvizëse, e cila nuk mund të jetë me pak se 190 cm, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore;
- b)** Elementin Urban, nëse ka, i cili nuk mund të jetë më pak se 90 cm, dhe;
- c)** Bordurën, e cila është 15 cm.

Neni 29 Hapësirat ku mund të vendosen pajisjet

1. Tabela e mëposhtme ilustron dhe llojet e pajisjeve që mund të vendosen në hapësirat e qytetit të përcaktuara në këtë rregullore ose me vendime të veçanta të Këshillit Bashkiak.


Tipet e paisjeve									
Tipet e zënimeve		Paisje të pa mbuluara	Çadra dielli	Tenda me strehë	Tenda me bimë kacavjërëse	Tenda diellore me pjerrësi/ mbyllëshme	Tipi 1	Tenda diellore	Tipi 2
f	Në parqe 								
g	Në trotuare								
h	Në trotuaret me portik								
i	Në zona të tjera								

2. Lejohet vendosja e tyre në të gjitha rastet që plotësojnë kushtet e rregullores dhe lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Vendosja e tyre është e diskutueshme dhe varet nga karakteristikat specifike të zonës.

Neni 30 Përcaktimi i zonave


Shfrytëzimi i hapësirave publike në Bashkinë Himare, klasifikohet në katër zona:

- Zona 1: Shetitoret nw vijw tw parw
- Zona 2: Ne qendrat e zonave urbane
- Zona 3: Nw toka me flukse mbi te cilat ka flukse per qellime turizmi
- Zona 4: Zona të tjera




Specifikime për tendat e diellit me strehë.


- Thellësia e tendës varion deri ne 100 cm.
- Gjerësia e tendes është max hapësira e jashtme e dyqaneve
- Ne cdo rast, ne mbyllje te aktivitetit ditor, tendat nuk duhet te jene te hapura.
- Ngjyra e paletave të tendave është fikse (shihni ngjyrat e paletave)




Ngjyrat e mundshme per tendat (RAL):




Ral 9001




Ral 1015




Ral 6013



Ral 6003



Ral 6502



Ral 7021

Specifikimet për strukturat hijëzuese:


1. Gjerësia e strukturës hijëzuese është sa maksimumi i gjerësisë së fasadës kryesore të objektit.
2. Gjatësia maksimale e strukturës hijëzuese shtrihet ne gjysmën e gjatësisë së frontazhit nga objekti deri në elementin kufizues shkurre dekorative.
3. Nuk duhet të cënohet qëndrueshmëria e objektit dhe të ruhet siguria e kalimtarëve.

b. Zona 2:

Frontazhi per kete zone eshte siperfaqja midis objekteve ekzistuese dhe zonës së gjelbërt.

Specifikime për tendat diellore.

- Thellësia e tendes varion deri ne 100 cm.
- Gjerësia e tendes është maksimumi sa hapësira e jashtme e njësisë.
- Ne cdo rast, ne mbyllje te aktivitetit ditor, tendat nuk duhet të jene të hapura.



Specifikimet për strukturë e përkohshme me materiale të çmontueshme:


Sipërfaqja e strukturës nuk duhet të jetë më shumë se 50% e sipërfaqes së hapësirës publike, e pozicionuar në pikën më të afërt me fasaden e objektit, dhe në çdo rast gjatësia, nuk duhet të jetë më shumë se gjysma e gjatësisë së seksionit të frontazhit. Gjerësia e strukturës së përkohshme me materiale të çmontueshme është sa maksimumi i gjerësisë së fasadës kryesore të objektit.

Specifikimet për strukturat hijëzuese:

1. Gjerësia e strukturës hijëzuese është sa maksimumi i gjerësisë së fasadës kryesore të objektit.
2. Gjatësia maksimale e strukturës hijëzuese është deri në 50% të gjatësisë së frontazhit nga objekti deri në elementin kufizues zona e gjelbërt.
3. Nuk duhet të cënohet qëndrueshmëria e objektit dhe të ruhet siguria e kalimtarëve.

c. Zona 3:

Frontazhi për këtë zonë deri në 11 m nga objekti ekzistues, duke respektuar si kufi maksimal ndarjen në kuota të ndryshme të shëtitores.





Specifikimet për strukturë e përkohshme me materiale të çmontueshme:

Sipërfaqja e strukturës nuk duhet të jetë më shumë se 50% e sipërfaqes së hapësirës publike, e pozicionuar në piken më të afërt me fasaden e objektit, dhe në çdo rast gjatësia, nuk duhet të jetë më shumë se gjysma e gjatësisë së seksionit të frontazhit. Gjerësia e strukturës së përkohshme me materiale të çmontueshme është sa maksimumi i gjerësisë së fasadës kryesore të objektit.

Specifikimet për strukturat hijëzuese:

1. Gjerësia e strukturës hijëzuese është sa maksimumi i gjerësisë së fasadës kryesore të objektit.
2. Gjatësia maksimale e strukturës hijëzuese është deri në 4 m.
3. Pedana prej druri lejohet deri në 5 m nga objekti.
4. Nuk duhet të cënohet qëndrueshmëria e objektit dhe të ruhet siguria e kalimtarëve.





d. Zona 4: Zona të tjera

Zona të tjera përfshihen të gjitha zonat e tjera brenda territorit të Bashkisë Himare, konkretisht:


Hapësira publike/trotuari me përmasa deri ne 300 cm e cila perfshin:

- Zonën Lëvizëse, e cila nuk mund të jetë me pak se 190 cm, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore;
- Elementin Urban, nëse ka, i cili nuk mund të jetë më pak se 90 cm, dhe;
- Bordurën, e cila është 15 cm.

Në kete rast hapësira publike/trotuari ju lihet këmbësorëve. Frontazhi nuk lejohet.

Hapësira publike/trotuari me përmasa nga 300 cm e deri tek fasada e objektit

- Kur hapësira publike/trotuari është mbi 300 cm, duhet të garantohet një Zonë Lëvizëse për këmbësorët baraz 190 cm, Elementi Urban baraz me 90 cm dhe Bordura baras me 15 cm.
- Në këtë rast Frontazhi për subjektet do të variojë deri në fasaden e objektit dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si psh. karrige, tavolina, saksitë, tendat etj) nuk duhet të kalojnë këtë sipërfaqe.
- Në rast se hapësira publike/trotuari është 300 cm, por mungojnë Elementet Urban, Frontazhit mbetet i njëjtë. Hapësira 90 cm i jepet Zonës Lëvizëse, duke lënë mundësinë që në të ardhmen, trotuari të pasurohet me Element Urban.



*shembull në rast se hapësira publike / trotuari është 370 cm.

Specifikime për tendat diellore.

- Thellësia e tendes varion deri në 100 cm.
- Gjerësia e tendes është max hapësira e jashtme e dyqaneve
- Në çdo rast, në mbyllje të aktivitetit ditë, tendat nuk duhet të jenë të hapura.

Specifikimet për strukturë e përkohshme me materiale të çmontueshme:

Sipërfaqja e strukturës nuk duhet të jetë më shumë se 50% e sipërfaqes së hapësirës publike, e pozicionuar në piken me të afërt me fasaden e objektit, dhe në çdo rast gjatësia, nuk duhet të jetë më shumë se gjysma e gjatësisë së seksionit të frontazhit. Gjerësia e strukturës së përkohshme me materiale të çmontueshme është sa maksimumi i gjerësisë së fasadës kryesore të objektit.

Specifikimet për strukturat hijëzuese:

1. Gjerësia e strukturës hijëzuese është sa maksimumi i gjerësisë së fasadës kryesore të objektit.
2. Gjatësia maksimale e strukturës hijëzuese është deri në 300 cm.
3. Pedana prej druri lejohet brenda gjatësisë së strukturës hijëzuese.
4. Nuk duhet të cënohet qëndrueshmëria e objektit dhe të ruhet siguria e kalimtarëve.

Neni 31 Përgjashtime dhe shtrirja e zbatimit të Kreu II

1. Distancat e përcaktuara në nenin 26 e e vijuese të Kreut II aplikohen në të gjitha rastet, përveç rasteve ku një itinerar lëvizje për arsye përdorimi të qëndrueshëm, të zgjatur në kohë, frekuentimit të rregullt dhe/ose intensiv ka fituar karakteristika identifikuese dhe përfaqësuese për një fashë të komunitet apo subkulturë urbane dhe popullaritet si pikë tubimi, socializmi dhe/ose shkëmbimi tematik.
2. Përgjashtimet jepen me vendim të Kryetarit të Bashkisë.
3. Përgjashtim nga parashikimet e mësipërme për pajisjen me leje sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre aplikohen për institucionet financiare, si dhe të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari për të cilat është e detyrueshme pajisja dhe mbajtja në gjendje pune e një gjeneratori.
4. Subjektet, të cilët ushtrojnë aktivitet në hapësira me funksion publik në pronësi private duhet të pajisen me leje për ushtrimin e aktivitetit, por janë të përjashtuar nga zbatimi i vendimit të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë së Himarës" (i ndryshuar), për tarifën e zënies së hapësirës publike. Subjektet i nënshtrohen të gjitha detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë kre në lidhje me distancat pa qenë të detyruar të pajisen me lejen përkatëse. Subjekti privat duhet të vërtetoj titullin e pronësisë nëpërmjet paraqitjes së dokumentit të pronësisë të tre muajve të fundit, si edhe dokumentacionin prej nga rrjedh e drejta e fitimit të pronësisë.

KREU IV EKSPOZIMI I MALLRAVE JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT

Neni 32 Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

1. Në këtë kre përcaktohen rregullat për mënyrën e ekspozimit të mallrave jashtë njësisë së tregtimit dhe pajisjen e tregtarëve me lejen përkatëse.
2. Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë aktivitetin e tij të ekspozimit të mallrave jashtë njësisë së tregtimit duhet që të pajiset me një leje të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban.
3. Ekspozimi i mallit jashtë njësisë së tregtimit pa lejen përkatëse të Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, do të konsiderohet shkelje dhe mbi subjektin do të merren masa ndëshkuese.
4. Leja do të lëshohet me një afat 1 vjeçar, por sipas kërkesës së vetë subjektit ky afat mund të jetë edhe për periudha sezonale nga 3 deri në 9 muaj.
5. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë dokumentacionin pranë Bashkisë Himare 15 ditë përpara fillimit të aktivitetit ose në çdo kohë të ushtrimit të tij.
6. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e plotë të përcaktuar në formularin e aplikimit.
7. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban është 15 ditë nga data e marrjes së aplikimit.

Neni 33 Ekspozimi i mallrave

1. Çdo subjekt që është i pajisur me leje për ushtrimin e aktivitetit për ekspozimin e mallrave jashtë njësisë së tregtimit, mund të ekspozojë vetëm këtë kategori mallrash jashtë saj: **a)** Fruta – perime;
b) Lule;
c) Libra, etj

Neni 34 Vendosja e pajisjeve

1. Për vendosjen e pajisjeve jashtë njësisë së tregtimit, mbahen parasysh këto kritere dhe distanca:
a) Pajisjet nuk duhen të jenë të fiksuara, si në tokë ashtu dhe në fasadën e ndërtesës;
b) Pajisjet duhet të jenë funksionale, të kenë një paraqitje të mirë estetike dhe të jenë të çmontueshme;

c) Për pajisjet me shtrirje vertikale distanca ndërmjet fasadës së ndërtesës ku ushtrohet aktiviteti dhe pjesës më ekstreme të pajisjes që shërben për të ekspozuar mallrat nuk duhet të jetë më e madhe se 1 metër;

d) Për pajisjet me shtrirje horizontale aplikohen kriteret e distancave të përcaktuara në nenin 26 e vijuese të Kreut II të kësaj rregullore.

Lartësia e pajisjes nga toka nuk duhet të jetë më e lartë se 2 metër.

Neni 35 Detyrimet e subjektit

Subjekti ka për detyrë të mbajë pastër hapësirën publike në të cilën zhvillon aktivitetin e ekspozimit për të cilin i është lëshuar leja.

Subjekti duhet të mirëmbajë pajisjet të cilat i shfrytëzon për të ekspozuar mallrat.

Subjekti në asnjë rast nuk duhet të hedhë përtokë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.

Neni 36 Pezullimi i lejes

Subjektit i pezullohet leja në rastet kur në hapësirën publike të lënë në dispozicion për t'u shfrytëzuar nga ai duhen të kryhen punime në interes të komunitetit.

Neni 37 Shkeljet

1. Përveç shkeljeve të përcaktuara në Kreun I, neni 10, pika 2 të kësaj rregullore për shkak të specifikave të aktivitetit konsiderohen shkelje dhe rastet në vijim:

a) Ekspozon mallra të ndryshëm nga ato të përcaktuar në lejen me të cilën është pajisur;

b) Aktiviteti është mbyllur dhe ai nuk ka larguar pajisjet nga zona.

2. Në këtë rast organi inspektues vepron në përputhje me parashikimet e Kreut I, neni 10, pikat 3, 4, 5 dhe 6 e kësaj rregullore.

KREU V ZHVILLIMI I PANAIREVE

Neni 38 Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

1. Në këtë pjesë të rregullores përcaktohen rregullat për mënyrën e organizimit/zhvillimit të panairove në hapësirat publike të Bashkisë Himare nga subjektet që kanë një eksperiencë në zhvillimin e tyre.
2. Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike për organizimin e një panairi duhet të pajiset me lejen përkatëse nga Bashkia Himare.
3. Afati i lejes mund të zgjatet me kërkesë të arsyetuar të subjektit dhe vendim të Kryetarit të Bashkisë apo strukturës përkatëse që ka miratuar dhe lëshuar lejen për zhvillimin e panairit.
4. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve minimumi 30 ditë përpara periudhës së parashikuar nga ana e tij për zhvillimin e panairit, duke cilësuar karakteristikat e panairit, dimensionet, tipologjia, sipërfaqja e vendeve të tregtimit, ditët e zhvillimit të aktivitetit dhe orarin përkatës.
5. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor, të përcaktuar në formularin e aplikimit.
6. Subjekti aplikues duhet t'i përmbahet disa rregullave për plotësimin e dokumentacionit teknik që kanë të bëjnë me:
 - Planvendosjen me vendet e tregtimit dhe duhet të përmbaj: i) Sipërfaqen e zonës në të cilën do të zhvillohet panairi; ii) Sipërfaqen e vendeve të tregtimit; iii) mënyra se si do të sistemohen subjektet në vendet e tregtimit; iv) përcaktimi i vendeve për çdo sektor të veçantë merceologjik.
7. Renderat e pajisjeve/njësive të tregtimit që do të instalohen për zhvillimin e aktivitetit të jenë të qarta dhe në to duhet të jenë të pasqyruara në mënyrë të veçantë pamja ballore, pamjet anësore dhe për njësitë e mbyllura edhe një pamje e brendshme.
8. Kërkesat konkurruese për të zhvilluar panairë në të njëjtin vend dhe në të njëjtat data do të shqyrtohen nga organet përkatëse dhe përzgjedhja e subjektit do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në vijim.
9. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban është 10 ditë nga data e marrjes së aplikimit.
10. Subjekti, i cili fiton të drejtën e organizimit të panairit/pjesëmarrjes, për të zhvilluar këtë aktivitet duhet t'i përmbahet rigorozisht normave të kësaj rregulloreje për mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të panairove.
11. Në rastet e arsyeve të forta që kanë për bazë interesat e komunitetit, Kryetari Bashkisë, apo struktura përkatëse që ka miratuar lejen për zhvillimin e panairit, ndryshon ditën dhe/ose orarin e zhvillimit të panairit dhe ky vendim i transmetohet subjekteve minimalisht 10 ditë përpara zhvillimit të aktivitetit.

Neni 39

Përzgjedhja në bazë të kriterëve të përparësisë

1. Në rastin kur disa subjekte kanë aplikuar për të zhvilluar një panair në të njëjtën periudhë kohore, Bashkia Himare, përzgjedhje subjektin duke u bazuar në kriteret e mëposhtme të cilat janë renditur sipas rëndësisë:

- a)** Numrin më të madh të organizimit të panaireve të zhvilluara në qytetin e Himares apo në qytete të tjera;
- b)** Në rastin kur subjektet konkurruese janë tërësisht të barabartë duke u bazuar në kriterin e mësipërm do të merret në konsideratë vjetërsia e subjektit, pra subjekti që ka filluar të ushtrojë aktivitetin e tij më përpara;
- c)** Në rast të barazisë së plotë do të merret në konsideratë dita e aplikimit të tij, data në të cilën është bërë protokollimi i kërkesës së subjektit pranë Bashkisë Himare.

Neni 40 Rregulla për zhvillimin e panairit

- 1. Oraret e zhvillimit të panaireve përcaktohen për çdo panair në mënyrë të veçantë. Subjektet mund të fillojnë të zënë vendet në panair jo më parë se 60 minuta nga fillimi i zhvillimit të aktivitetit.
- 2. Aparaturat akustike duhet të kenë një amplifikë të moderuar e cila të mos krijojë probleme si për komunitetin ashtu edhe për subjektet e tjerë.
- 3. Brenda të njëjtit sektor merceologjik dhe duke respektuar normat higjeno-sanitare për sektorin ushqimor, lejohen subjektet në mirëkuptim me njëri-tjetrin të shkëmbejnë vendet midis tyre.

Neni 41 Zgjerimi i sipërfaqes së vendit të tregtimit

- 1. Kërkesat për të zgjeruar sipërfaqen e vendit të tregtimit të autorizuar pranohen në rast se ka hapësira të lira në dispozicion dhe kjo nuk përbën asnjë lloj shqetësimi për qytetarët dhe për sigurinë dhe qarkullimin e mjeteve dhe këmbësorëve.
- 2. Për të mos krijuar vështirësi në lëvizjen e automjeteve dhe atë të këmbësorëve gjatë zhvillimit të panaireve është e ndaluar zhvillimi i tregtisë në tregje të lëvizshme në një rreze prej 300 m.

Neni 42 Rregullat higjeno-sanitare

1. Të gjitha subjektet që marrin pjesë në panair janë të detyruar të mbajnë pastër ambientin përreth vendit të tyre të punës. Mbeturinat si dhe çdo mbetje tjetër duhet të hidhen në vendet e caktuara për këtë qëllim.
2. Tregtimi dhe shpërndarja e ushqimeve dhe e pijeve në panaire duhet t'i përmbahet normave higjeno-sanitare. Të gjithë punonjësit që tregtojnë mallra ushqimore, duhet të jenë të pajisur me librezë shëndetësore.
3. Produktet ushqimore duhet të vendosen në një lartësi jo më të vogël se 50 cm nga toka.

Neni 43 Sanksionet

1. Përveç shkeljeve të përcaktuara në Kreun I, neni 10, pika 2 të kësaj rregullore, për shkak të specifikave të aktivitetit konsiderohen shkelje dhe rastet në vijim:
 - a) Kur subjekti tregon/eksponon mallra të një tipologjie të ndryshme nga ajo e autorizuar;
 - b) Kur përdor aparatë fonike me foni të lartë e cila krijon shqetësime për të promovuar mallrat të cilat tregton.
2. Në këtë rast organi inspektues vepron në përputhje me parashikimet e Kreut I, neni 10, pikat 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregullore.

Neni 44 Qarkullimi rrugor

1. Strukturat përkatëse që shqyrtojnë dhënien e lejeve duhet të njoftojnë Policinë Bashkiake/organet kompetente, në lidhje me zhvillimin e aktivitetit dhe oraret për të cilat ai do të zhvillohet në mënyrë që të merren të gjitha masat e nevojshme.
2. Në rastin kur për zhvillimin e panairit është e nevojshme bllokimi dhe devijimi i qarkullimit të automjeteve apo nëse do të nevojitet për mbarëvajtjen e aktivitetit, atëherë në lejen për zhvillimin e panairit shënohet edhe bllokimi apo devijimi i qarkullimit. Policia Bashkiake në këtë rast merr të gjitha masat e nevojshme.

KREU VI ZËNIA E HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE PROMOVUESE, ARTISTIKE, KULTURORE, MANIFESTIMEVE POLITIKE E TË TJERA

Neni 45

Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

1. Në këtë kre përcaktohen rregullat e dhënies së lejes së përkohshme për zhvillimin e aktivitete promovuese, artistike dhe/ose kulturore, sportive, sociale dhe/ose komunitare, manifestime politike e të tjera.
2. Subjekti që kërkon të zhvillojë aktivitete promovuese, artistike dhe/ose kulturore, sportive, sociale dhe/ose komunitare, manifestime politike në hapësirat publike të Bashkisë Himare duhet të pajiset me lejen përkatëse të lëshuar nga Bashkia Himare.
3. Leja për të zhvilluar këto aktivitete është e përkohshme, afati maksimal të cilës është jo më shumë se 1 muaj.
4. Kur një subjekt është i pajisur me leje zhvillim aktiviteti promovuese, artistike dhe/ose kulturore, sportive, sociale dhe/ose komunitare, manifestime politike për disa ditë dhe në leje nuk është specifikuar orari, leja është e vlefshme duke nisur nga ora 6:00 e mëngjesit deri në orën 23:00 të mbrëmjes për çdo ditë të vlefshmërisë së lejes së miratuar.
5. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën pranë Bashkisë Himare të paktën 15 ditë përpara periudhës së parashikuar nga ana e tij për të kryer aktivitetin. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor, të përcaktuar në formularin e aplikimit.
6. Në raste urgjente kërkesa mund të pranohet dhe 7 ditë përpara ditës që subjekti kërkon të ushtrojë aktivitetin.
7. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga struktura përgjegjëse është 10 ditë nga data e marrjes së aplikimit (*përfashtuar rastet urgjente*).

Neni 46 Vendosja e pajisjeve

1. Instalimet e pajisjeve për të zhvilluar aktivitetin në hapësirat e lejuara për manifestime të ndryshme si: festivale, zhvillime festash të ndryshme e të tjera mund të vendosen maksimalisht 1 ditë përpara zhvillimit të aktivitetit.
2. Për aktivitete të cilat kërkojnë më shumë kohë në dispozicion, instalimi i pajisjeve mund të kërkoj edhe më shumë se 1 ditë dhe vlerësohet në përputhje me kërkesën e paraqitur nga subjekti.

Neni 47 Subjektet të cilat përjashtohen nga pagesa për zënien e hapësirës publike

Bëjnë përjashtim nga pagesa për zënien e hapësirës publike ato subjekte që kryejnë aktivitetet e mëposhtme:

1. Kur manifestimet organizohen apo financohen nga Bashkia Himare, apo kur Bashkia Himare bashkëpunon me subjektet e tjera.
2. Kur hapësira publike zihet për zhvillimin e manifestimeve humanitare, fetare, partitë politike apo institucionet shtetërore, të cilat njihen nga legjislacioni shqiptar dhe janë të lidhura ekskluzivisht me kultin të cilin e predikojnë.

3. Kur hapësira publike zihet për zhvillim koncertesh nga grupe muzike të cilat nuk kanë qëllim përfitimi. Kjo është e vlefshme kur hyrja është falas.
4. Kur hapësira publike zihet për rastin e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive të festave të fundvitit me kusht që subjektet të ofrojnë dhe shërbime argëtuese falas në favor të qytetarëve dhe komunitetit. Përfshirja nga pagesa përfshin vetëm atë pjesë të hapësirës publike për të cilën ofrohen këto shërbime dhe veprimtari.
5. Subjektet e lartpërmendura duhet t'i cilësojnë këto rrethana në kërkesën e paraqitur pranë Bashkisë Himare.
6. Pagesa e kryer nuk rimburohet, por subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në një moment tjetër kundrejt pagesës së kryer.

Neni 48 Shfuqizim i lejes

1. Në rastin kur hapësira publike e miratuar për subjektin nga struktura përgjegjëse e Bashkisë Himare, për arsye të forta dhe objektive nevojitet për të kryer një aktivitet tjetër më të rëndësishëm të paparashikuar dhe të organizuar nga Bashkia Himare, vendimi për dhënien e lejes subjektit të parë mund të shfuqizohet ose të transferohet në një hapësirë tjetër publike.
2. Në këtë rast subjektit të cilit i shfuqizohet leja duhet t'i komunikohet ky vendim jo më vonë se 24 orë para fillimit të aktivitetit. Shfuqizimi duhet të shoqërohet së bashku me arsyet konkrete.
3. Subjekti, të cilit i shfuqizohet leja e dhënë, ka të drejtë të kryejë aktivitetin e tij në një datë tjetër të përcaktuar dhe në koordinim me Bashkinë.

Neni 49 Qarkullimi rrugor

1. Strukturat përgjegjëse që shqyrtojnë dhënien e lejeve, pranë Bashkisë Himare duhet të njoftojnë Policinë Bashkiake/organet kompetente në lidhje me zhvillimin e aktivitetit dhe oraret për të cilat ai do të zhvillohet në mënyrë që të merren të gjitha masat e duhura për bllokimin e qarkullimit të automjeteve, nëse do të nevojitet për mbarëvajtjen e aktivitetit.
2. Në rastin e aktiviteteve, kur nuk është e nevojshme bllokimi i rrugës, si manifestime të ndryshme si: festivale, zhvillime festash të ndryshme e të tjera, Strukturat përgjegjëse që shqyrtojnë dhënien e lejeve, sipas rastit, njoftojnë Policinë Bashkiake mbi zhvillimin e aktivitetit dhe nëse vlerësohet e nevojshme, të marrë masa në mbarëvajtjen e tyre.
3. Në rastin kur për zhvillimin e aktiviteteve është e nevojshme bllokimi dhe devijimi i qarkullimit të automjeteve apo nëse do të nevojitet për mbarëvajtjen e aktivitetit, atëherë në lejen për zhvillimin e panairit shënohet edhe bllokimi apo devijimi i qarkullimit. Policia Bashkiake në këtë rast merr të gjitha masat e nevojshme.

KREU VII

ZËNIA E HAPËSIRËS REKLAMUESE (CITY LIGHTS) DHE (TABELAT REKLAMUESE/ LED)

Neni 50 Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

1. Ky kre përcakton rregullat për mënyrën e zënies/përdorimit të hapësirave publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitete reklamuese ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre në hapësira publike për (*City Lights*) dhe (*Tabelat Reklamuese/ Led*).
2. Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të reklamimit, duhet të pajiset me lejen përkatëse të lëshuar nga Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Himare.
3. Për këtë kategori aktiviteti, afati i lejes për zënie e hapësirës publike është 1 vjeçar.
4. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesë pranë Bashkisë Himare. Kërkesa duhet e shoqërohet me dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor, të përcaktuar në formularin e aplikimit.
5. Subjekti aplikues duhet t'i përmbahet disa rregulla për plotësimin e dokumentacionit teknik që kanë të bëjnë me genplanin ose planimetritë dhe fotot e pajisjeve që do të përdoren për reklamim, si më poshtë vijon:
 - a) skicat duhet të jenë të punuara, dhe t'u përmbahen rigorozisht parametrave të vendosura në vijim;
 - b) Renderat do të jenë të qarta dhe në to duhet të jenë të pasqyruara veçmas pamja ballore, pamjet anësore. Në të gjitha renderat duhet të jenë e shënuar data e kryerjes së tyre.
6. Në rastin kur subjektet që pajisen me leje për zënie/përdorimin e hapësirës publike për vendosjen e Tabelave Reklamuese/ Led dhe bashkëpunojnë me Bashkinë Himare, duke ofruar për këtë institucion reklama dhe mesazhe sensibilizuese, promovuese të eventeve në qytet, informimit në shërbim të komunitetit dhe publikut, do të përjashtohen apo do t'u krijohen lehtësira nga pagesa e tarifës.
7. Përjashtimi nga pagesa e tarifës përcaktohet në marrëveshjen e nënshkruar nga Bashkia Himare/Struktura Pergjegjese dhe subjektit përkatës, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta të palëve.

Neni 51 Dimensionet dhe distancat

1. *City Lights*) dhe (*Tabelat Reklamuese/ Led*) duhet të kenë një formë drejtkëndore dhe të jetë me dimensione: 1.2 m i gjerë dhe 1.8 m i lartë, jo më shumë se 40 cm i trashë.
2. *City Lights* përdoren vetëm për reklamim/informim nëpërmjet posterave me tekste dhe imazhe. Nuk lejohet të përdoret për qëllime të tjera.
3. *City Lights* duhet të jenë të vendosur pingul ose horizontal me trupin e rrugës, fill pas bordurës që ndan trupin e rrugës me trotuarin, duke lënë të lirë zonën lëvizëse në trotuar dhe korsinë e biçikletave (nëse ka).
4. Lejohet vendosja e *City Lights* vetëm në ato raste kur trotuari apo hapësira publike e vendosur është jo më pak se 3.4 m e gjerë duke filluar nga bordura e trotuarit deri tek Fasada e

objektit dhe duke lënë minimum 2 m për zonën lëvizëse, pa përfshirë zonën e Frontazhit të përdorur nga subjektet tregtare, nëse ka. Në këtë përlllogaritje nuk përfshihet në asnjë rast korsitë e biçikletave (nëse ka) apo elementë të tjerë përbërës të trupit të rrugës.

5. City Lights duhet të vendoset në një rreze prej të paktën 2.5 m larg çdo elementi urban që e kufizon si p.sh pemë, kosh plehrash, ndriçues urban, sinjalistikë rrugore, hidrant etj dhe 10 m larg semaforëve dhe rampave.


6. City Lights duhet të kenë një distancë prej të paktën 70 m njëri- tjetri, kur trotuari është i vazhdueshëm e nuk ka ndërprerje me rrugë.

Shembull:

KREU VIII ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE AMBULATORE NË HAPËSIRAT PUBLIKE TREGJET

Neni 52 Objekti

Ky kre përcakton rregullat për pajisjen e tregtarëve ambulantë me leje për zhvillimin e aktivitetit të tyre në tregje të lëvizshëm apo fiks ose njësitë e shitjes ambulatory në hapësirat publike të Bashkisë.



Neni 53 Leja për zënien e hapësirës publike

Çdo subjekt që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të zhvillimit të aktivitetit të tregtisë ambulatory, duhet të pajiset me lejen përkatëse nga organet autorizuese të përcaktuara në këtë rregullore.

Leja është personale/unike dhe e patransferueshme tek çdo person/subjekt tjetër.

Për interes publik apo në raste kur cenohet siguria dhe shëndeti i njerëzve lejet janë të revokueshme në çdo moment.

Leja ka afat maksimal 1 (një) vjeçar dhe mund të rinovohet në përfundim të këtij afati, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktura në këtë rregullore.

Me kërkesë të vetë subjektit, kjo leje mund të lëshohet edhe për periudha sezonale, me afat nga 3 deri në 9 muaj.

Neni 54 Njësitë e shitjes ambulante

1. Tregtarët që kryejnë aktivitetin në njësitë e shitjes ambulante duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara më poshtë:

a) të mos zënë sipërfaqe më të mëdha se 4 m², me përjashtim të rulotave;

b) mallrat duhet të ekspozohen në pajisje të lëvizshme në një lartësi minimale nga trualli prej 0,5 m dhe pjesa e poshtme e mbulesës (*tendat*) duhet të jenë të paktën 2 m nga trualli, mbulesa duhet të jetë e sigurtë dhe në asnjë rast nuk duhet të kalojë hapësirën që i është caktuar subjektit; **c)** pajisjet mund të jenë të integruara edhe në biçikleta, mund të kenë rrota të mëdha ose të vogla, mund të kenë element hijezues të tipit çadër, tendë, mbulesë. Nuk duhet të kenë element të dalë që mund të dëmtojnë këmbësorët, apo çdo pajisje tjetër teknike (*kablllo, bombol gazi, gjenerator, kavo etj*). Përjashtim nga sa më sipër bëjnë rulotat. Me akte të Kryetarit të Bashkisë mund të përcaktohen modellet tip të pajisjeve që duhet të përdoren nga tregtarët ambulant, përfshirë këtu rulotat

d) njësitë e shitjes ambulare lejohen vetëm në sheshe publike apo parqe dhe në zonat me aktivitet të dendur/intensiv social dhe ekonomik;

e) nuk lejohen njësitë e shitjes ambulare që tregtojnë produkte ushqimore të përpunuara në një vendndodhje të caktuar ku në një rreze prej më pak se 50 m ekziston një bar, restorant, fastfood apo dyqan fruta-perimesh;

f) nuk lejohen njësitë e shitjes ambulare që tregtojnë lule në një vendndodhje të caktuar ku në një rreze prej më pak se 50 m ekziston një dyqan lulesh;

g) nuk lejohen njësitë e shitjes ambulare që tregtojnë produkte duhani, kinkaleri, pije freskuese në një vendndodhje të caktuar ku në një rreze prej më pak se 50 m ekziston një dyqan apo strukturë e përkohshme mikse që tregon këto produkte;


h) nuk lejohen njësitë e shitjes ambulare pranë institucioneve publike;

i) vendndodhja e një njësie shitje ambulare duhet të ketë një distancë minimum prej 30 m nga një njësi e shitjes ambulare tjetër;

j) njësia e shitjes ambulare duhet të jetë të paktën 2 m larg një elementi urban (*pemë, stol, stacion autobuzi, tabelë, koshi etj*). Duhet të garantohet gjithmonë minimumi i lëvizshmërisë së këmbësorëve me një distancë prej 2.35 m nga fasada e objektit tek pajisja e njësisë së shitjes ambulare;

k) njësitë e shitjes ambulare duhet të jenë të paktën 3 m larg një hyrje objekti apo parkimi për persona me aftësi të kufizuar.

Shembull:



Neni 55 Procedura e dhënies së lejes

1. Kushdo ka të drejtë të aplikojë për t'u pajisur me leje për ushtrimin e tregtisë ambulatorë në tregjet e miratuara nga Bashkia Himare ose si njësi shitje ambulante, me kusht që të jetë madhor, të gëzojë zotësi juridike për të vepruar dhe të jetë i regjistruar në sipas legjislacionit në fuqi.
2. Personi/subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën për të ushtruar tregtinë ambulatorë në tregjet e lëvizshëm apo fikse pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik . Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e plotë të përcaktuar në formularin e aplikimit.
3. Për tregtinë ambulatorë në tregje, paraqitja bëhet çdo fillim viti pasi institucioni të ketë shpallur numrin e vendeve bosh në tregje. Kërkesa për rinovimin e lejes paraqitet 30 ditë para përfundimit të saj.
4. Në miratimin e kërkesës për plotësimin e vendeve të tregtimit në këto tregje do të ndiqen në mënyrë transparente plotësimi i kushteve nga çdo aplikant. Në vlerësim/kualifikim u jepet përparësi në radhë rëndësie:
 - (i) plotësimi të dokumenteve të kërkuar;
 - (ii) datës së paraqitjes të kërkesës (sipas numrit të referencës së protokollit në momentin që subjekti ka aplikuar);
 - (iii) vjetërsisë në ushtrimin e tregtisë në atë treg ose;
 - (iv) si ambulant.
5. Për njësitë e shitjes ambulante subjektet që do të aplikojnë duhet të mbajnë parasysh disa rregulla për plotësimin e dokumentacionit teknik që kanë të bëjnë me dorëzimin e një planvendosje, foto, skica ose projekt të pajisjes për njësinë e tregtimit ambulant dhe listën e produkteve të parashikuara për t'u tregtuar.
6. Për njësitë e shitjes ambulante shqyrtimi i kërkesës ka për qëllim të verifikoj vendndodhjen, produktin që do të tregtohet, llojin e pajisjes dhe dizajni, materialet e përdorura,

ngjyrat dhe logot në njësinë e tregtimit ambulant të cilat duhet të jenë në harmoni me funksionin dhe estetikën e hapësirës publike në të cilën do të vendosen.

7. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga organet autorizuese është 10 ditë nga data e marrjes së aplikimit ose mbylljes së afatit për aplikim.

Neni 56

Funksionimi i tregut dhe i njësive të shitjes ambulante

1. Aktiviteti i tregjeve dhe njësive të shitjes ambulante zhvillohet në të gjitha ditët e javës. Me akte të Kryetarit të Bashkisë nëse lind nevoja mund të përcaktohet dita pushim në tregun fiks. Me kërkesë të subjektit të interesuar mund të përcaktohet dita pushim për njësinë e shitjes ambulante.
2. Bashkë me përcaktimin e vendeve, Bashkia Himare harton edhe kalendarin dhe rregulloren e funksionimit për secilin treg fiks apo të lëvizshëm.
3. Orari i shitjes në treg dhe për njësitë e shitjes ambulante përcaktohen në leje përkatëse.
4. Përgatitja për vendosjen e pajisjeve fillon 90 minuta përpara fillimit të funksionimit të tregut dhe hapësira e zënë duhet të lihet e lirë brenda 60 minuta nga përfundimi i orarit të tregtimit.
5. Tregtarët janë të detyruar të zbatojnë në mënyrë rigoroze orarin e miratuar në leje. Nuk lejohet braktisja e tregut brenda kohëzgjatjes së orarit të përcaktuar.
6. Përcaktimi i një dite në javë si ditë pushimi, do të bëhet me kërkesë të vetë subjektit dhe/ose me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

Neni 57 Mallrat që do të tregtohen dhe vendi i tregtimit

1. Hapësira e tregut ndahet sipas sektorëve merceologjikë dhe mbi këtë bazë bëhet edhe caktimi i vendeve për secilin tregtar.
2. Tregtarët janë të detyruar të nxjerrin në shitje vetëm artikujt e planifikuar për sektorin të cilit i përkasin, gjë e cila është e përcaktuar në lejen përkatëse të Bashkisë Himare.
3. Nuk lejohet ekspozimi dhe shitja në të njëjtin vend e mallrave industriale dhe atyre ushqimore.
4. Njësitë e shitjes ambulante mund të tregtojnë kryesisht produkte ushqimore të përpunuara, kinkaleri, lule dhe produkte duhani.
5. Tregtarët ambulantë që kryejnë aktivitetin në këto tregje duhet të mbajnë parasysh kushtet e përcaktuara si më poshtë:
 - a) të mos zënë sipërfaqe më të mëdha apo të ndryshme nga ajo e përcaktuar në lejen e lëshuar;
 - b) mallrat duhet të ekspozohen në banakë në një lartësi minimale nga trualli prej 0,5 m dhe pjesa e poshtme e mbulesës (*tendat*) duhet të jenë të paktën 2 m nga trualli. Mbulesa duhet të jetë e sigurtë dhe në asnjë rast nuk duhet të kalojë hapësirën që i është caktuar subjektit;

6. Me qëllim që të garantohet një zhvillim sa më normal i tregut, në të nuk lejohet përdorimi i asnjë lloj aparati amplifikimi, përjashtuar tregtarët e produkteve audio-vizive. Këto të fundit duhet të kenë parasysh mbajtjen e volumit të zërit brenda limiteve që nuk i sjellin shqetësim pjesëmarrësve dhe frekuentuesve të tregut.

Neni 58 Afishimi i çmimeve

Është i detyrueshëm afishimi i çmimeve të shitjes. Tregtari në mënyrë të dukshme duhet të afishojë etiketat e çmimeve të mallrave të ekspozuara për shitje.

Neni 59 Kontrolli higjeno-sanitar

Tregtimi i artikujve ushqimorë i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe kontrollit të autoriteteve shëndetësore. Të gjithë tregtarët duhet të jenë të pajisur me librezë shëndetësore. Ata duhet t'i nënshtrohen të gjitha kontrolleve periodike dhe të respektojnë të gjitha rregullat e nxjerra nga organet kompetente.

Neni 60 Pastrimi

1. Pastrimi i përgjithshëm i tregut apo i vendit ku është vendosur pajisja ambulante do të kryhet nga Bashkia Himare në përfundim të orarit të tregtimit, pas heqjes së pajisjeve dhe largimit të tregtarëve.
2. Njëkohësisht është e detyrueshme për çdo tregtar mbajtja pastër e vendit të tregtimit. Ata në asnjë rast nuk duhet të hedhin në tokë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojnë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.

Neni 61 Shkeljet

1. Përveç shkeljeve të përcaktuara në Kreun I, neni 10 të kësaj rregullore për shkak të specifikave të aktivitetit konsiderohen shkelje dhe rastet në vijim:
 - a) Shkelja e rregullave të përcaktuara për tregtimin në këto tregje sipas kësaj rregulloreje apo legjislacionit të fuqi;
 - b) Vendi i tregtimit në treg apo pajisja lihet në shfrytëzim një subjekti tjetër, i cili është i paautorizuar;
 - c) Në këtë rast organi inspektues vepron në përputhje me parashikimet e Kreut I, neni 10, pikat 3, 4, 5 dhe 6 të kësaj rregullore.

KREU IX
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 62 Dispozita kalimtare

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në hapësirat publike në territorin e Bashkisë Himare, brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje të marrin masat për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me kushtet dhe kriteret e vendosura në këtë rregullore.

Neni 63 Hyrja


në fuqi Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Dhimitër KAPAJ




Kioske Modeli 1





Permasat: 8m x 4m

Ngjyra e propozuar RAL 7006 :







Kioske Modeli 2



Planimetri konceptuale: Permasat 3.5m x 4.5 m





Kioske modeli 3





Planimetri konceptuale: Permasat 3.5m x 6 m

Kioske Modeli 3




Size: 3.6m by 2.2m

Materialet: wood aluminum composite panel, black aluminum composite panel

Kioske modeli 4



Permasat 3.5m x 6 m



creating better places.

cityförster
architecture + urbanism



KIC


CONTEXT

SITEPLAN

DHERMI STREET


Natural Elements

-  Dhermi Entrance
-  New bus park (S)





SITEPLAN

DEMOLISHED KIOSKS




Batllëq, Elbasan




IMAGES

EXISTING/ DEMOLISHED KIOSKS



SITEPLAN

VEGETATION





Natural Elements




SITEPLAN

NEW PROPOSAL STREET



REPLACEMENT KIOSKS

2 OPTIONS




Option 1
Roof

Option 2
Sloped Tower


OPTION1

Roof




Indigenous Plant Species

+



A rational well designed building !


+





A freedom for the owner to build

OPTION1A

ROOF





This is a variation to the previous option, however the supporting columns are moved to the middle of each side and frees up the corners






OPTION1A

DRAWINGS





PIZZA OPTION


ROOF



SHOP OPTION

RÖÖF






before



ON SITE




before



MATERIALITY


ROOF



The design of this particular option revolves around the local flora and durable materials. The plants on the roof require low to no maintenance and are local indigenous species. The use of plants on the roof will reduce the thermal impact on the structure and also will be aesthetically pleasing.

OPTION2


SLOPED TOWER




a transformed tower

OPTION2


TAPERED TOWER





the option works as a wayfinding point with all the elements contained within the volume. It provides security during the closing hours and additional storage within the upper volume






the cover of the terrace is



COFFEE DRAWINGS




PIZZA OPTION




this version of the volume shows the largest typology that still categorises as a kiosk. It offers a lot of flexibility and possible usage. It is also suitable for all kind of food or drink programs.


PIZZA DRAWINGS





SHOP OPTION






even though this is the smallest size from the typology it provides snough shading for the customers and shop assistant






SHOP OPTION






before






before



OVERVIEW

TYPOLOGIES



OVERVIEW

MODELS

